

TRAJTIMI I FEMRËS SIPAS ISLAMIT

سُبْحَانَ الَّذِي خَلَقَ الْأَزْوَاجَ كُلَّهَا مِمَّا تُثْبِتُ الْأَرْضُ وَمِنْ أَنْفُسِهِمْ وَمِمَّا لَا يَعْلَمُونَ

I pastër nga të metat është Ai që krijoi të gjitha llojet (çiftet) nga çka mban toka, nga vetë ata dhe nga çka ata nuk dinë .

Gjithashtu Allahu xh.sh. ka thënë:Dhe Ne ju krijuam juve në çifte. **وَخَلَقْنَاكُمْ**

أَزْوَاجًا

Para Islamit gjithë popujt e tokës e ulnin dhe e zhvlerësonin femrën. Derisa më së shumti nga ajo që kishin arritë ata ishte gjykimi i tyre perfundimtar: pranimi dhe miratimi i femres si qenie njerëzore, e qe nuk mund të diskutohej vlera, nderimi dhe barazia e saj me mashkullin ne të drejta dhe obligime.

Ajo tek disa popuj konsiderohej vetëm si mjet zbavitje dhe shfrenimi dhe këtë mund ta kuptojmë më mirë tek fjalët e Dimostinit, i cili tha: "Ne i marrim lavret për kënaqësi dhe marrim të dashurat për përkujdesjen shëndetit tonë dhe i marrim gratë që të kemi femijë të ligjshëm".

Tek romaket kishte të drejtë prindi apo burri ta shesë atë për ke të dojë. Ndërsa tek arabet kishte të drejtë i biri i burrit të saj ta trashëgojë atë ashtu siç i trashëgon gjitha gjërat tjera nga prindi i tij. E shpetimi më i madh i saj ishte nëse ajo nuk varrosej për së gjalli. Kështu njejtë trajtohej edhe tek persianet, indianet dhe popujt e tjerë.

Deri në këtë kohë askush nuk mendoi për ndonjë kthese rrenjësore në këtë drejtim, e as që ndërmoi dikush gjë për të drejtat e saja. Deri kur?

Deri kur erdhi Islami, i cili njohu barazinë e saj me mashkullin dhe ia dha të drejtat e saja të plota, që ta shpëtojë nga ky trajtim i tmerrshëm dhe i turpshëm, dhe ta ngritë atë në vendin e saj të duhur dhe meritues.

Barrijerat propaganduese anti njerzore e veçanarishtë anti femrore baza e të cilave është tek devijimet që bënë në librat e shpallura iu mveshen edhe islamit të apstërt të ruajtur nga vetë Allahu xh.sh. kështuqë shpesh ndehsim hutira të pa bazuara në islam se gjoja edhe sheriati nënçmon apo nuk e konsideron femren muslimane.Subhanalla.Këto intriga nuk janë të familjes hyjnore islame këto janë vetëm shpifje ndaj këtij dini të madhë.Por ky dinë me gjitha rregullat logjikat,urdhërat lejesat e ndalesat ëhstë i zbritur nga Allahu i lartësuarë e mendja njerëzore është munduar e do të mundohet ta njollosë por asnjëherë nuk ka qenë e as nuk do të jetë e sukseshme.

Erdhi vendimi islam dhe në formë të prerë sqaroi prejardhjen dhe origjinen e llojit njerëzor dhe atë ne shumë ajete, si:

يَا أَيُّهَا النَّاسُ اتَّقُوا رَبَّكُمُ الَّذِي خَلَقَكُمْ مِنْ نَفْسٍ وَاحِدَةٍ وَخَلَقَ مِنْهَا
زَوْجَهَا وَبَثَّ مِنْهُمَا رِجَالًا كَثِيرًا وَنِسَاءً

"O ju njerëz, kinie frikë Zotin tuaj, i Cili ju krijoi prej një veteje (njeriu) dhe nga ajo krijoi palën (shoqen) e saj, e prej atyre dyve u shtuan shumë burra e gra." [En-Nisa, 1]

Ashtu siç erdhi vendimi për krijimin e llojit njerëzor në fillim, ashtu do të jetë edhe perfundimi i tyre, qofshin ata meshkuj apo femra, të gjithë do të gjejnë shperblimin apo ndeshkimin e tyre, varesisht nga puna që kanë punuar në dunja.

Siç thotë All-llahu [subhanehu ve teala]: "Dhe se njeriut nuk i takon tjetër vetëm se ajo qe ka punuar. Dhe se munda i tij më vonë (Diten e Gjykimit) do të shihet. Pastaj, ai shperblehet me shperblimin më të plotë. Dhe se kthimi i fundit do të jetë të Zoti yt."

Apo siç thotë:

فَاسْتَجَابَ لَهُمْ رَبُّهُمْ أَنِّي لَا أُضِيعُ عَمَلَ عَامِلٍ مِّنْكُمْ ذَكَرَ أَوْ أُنْثَى
مِّنْ

"Zoti i tyre iu përgjigj lutjes së tyre (e tha): Unë nuk ia humbi mundin asnjërit prej jush, mashkull qoftë apo femër."

Si dhe në ajetin:

وَمَنْ يَعْمَلْ مِنَ الصَّالِحَاتِ مِنْ ذَكَرٍ أَوْ أُنْثَىٰ وَهُوَ مُؤْمِنٌ
فَأُولَٰئِكَ يَدْخُلُونَ الْجَنَّةَ وَلَا يُظْلَمُونَ نَقِيرًا

"Kush bën ndonjë nga punët e mira, qoftë mashkull apo femër duke qenë besimtar, të tillët hyjnë në xhennet dhe nuk u behet fare padrejtesi."

All-llahu xh.sh dërgoi peygamberë dhe zbriti libra drejtuar njerëzimit, drejtuar meshkujve dhe femrave pa kurrfar dallimi. Dhe personaliteti femëror krahas me atë mashkullor është i njëjtë në urdhërat dhe ndalesat e Islamit. Dhe nga ajo kërkohet që të besojë në All-llahun Një, në librat dhe peygamberët e Tij, dhe gjithashtu të ketë kujdes dhe mos të afrohet në prostitucion, alkool, etj. Ajo ka përgjegjësi të plotë në të gjitha këto, sikurse mashkulli. Shih sa bukur Allahu xh.sh ka potencuar dy gjinitë për të mos lënë hapsirë të mendjelehtëve t'u besojnë atyre që shpifin për islamit se dallon mashkullin nga femra në adhurime ,përvuajtje e sprova të ndryshme,në ruajtjen e nderit dhe përkujtimin e Allahut Krijues.

Allahu i madhëruarë thotë:

إِنَّ الْمُسْلِمِينَ وَالْمُسْلِمَاتِ وَالْمُؤْمِنِينَ وَالْمُؤْمِنَاتِ
 وَالْقَانِتِينَ وَالْقَانِتَاتِ وَالصَّادِقِينَ وَالصَّادِقَاتِ وَالصَّابِرِينَ
 وَالصَّابِرَاتِ وَالْخَاشِعِينَ وَالْخَاشِعَاتِ وَالْمُتَصَدِّقِينَ
 وَالْمُتَصَدِّقَاتِ وَالصَّائِمِينَ وَالصَّائِمَاتِ وَالْحَافِظِينَ
 فُرُوجَهُمْ وَالْحَافِظَاتِ وَالذَّاكِرِينَ اللَّهَ كَثِيرًا
 وَالذَّاكِرَاتِ أَعَدَّ اللَّهُ لَهُمْ مَغْفِرَةً وَأَجْرًا عَظِيمًا

"Nuk ka dyshim se për muslimanët e muslimanet, besimtarët e besimtare, adhuruesit e adhurueset, të sinqertit e të sinqertat, durimtarët e durimtare, të përvuajturit e të përvuajturat, sadakadhënësit e sadakadhënëset, agjëruesit e agjërueset, ruajtësit e nderit e ruajtëset e nderit, shumë përmendësit e All-llahut e shumë përmendeset e All-llahut, All-llahu ka pergatitur falje (mekatësh) e shpërblim të madh."

Si nga meshkujt ashtu edhe nga femrat ka pasur ka e do të ketë dy lloje personalitetesh besimtarë e pa besimtarë ,kanë potencuar ajetet e kur'anit shumë prej shembujve të besimtarëve si dhe pabasimtarëve nga meshkujt e nga femrat. Bile nga këndi artistiko edukativ kur'ani u qaset të gjitha kategorove njerëzore, duke filluar që nga fëmijët, djelmoshat vajzat nëna, babai të rinjë e të vjetër gra e burra peq e plaka sepse për të gjitha kategoritë edhe ka zbritur. Kur'ani është planprogram i Allhut krijues për të njeriun. E të gjitha kohërave e të gjith kategorive, dhe sjell shembull nga e kaluara për të marrë mësim ata që vijnë. meqenëse jemi tek tema për trajtimin e femrës sjellim disa ajete sinjalizuese për kategorin në fjalë:

ضَرَبَ اللَّهُ مَثَلًا لِّلَّذِينَ كَفَرُوا امْرَأةً نُّوحَ وَاِمْرَأةً لُّوطٍ كَانَتَا تَحْتَ
 عِبْدَيْنِ مِّنْ عِبَادِنَا صَالِحَيْنِ فَخَاتَتَاهُمَا فَلَمَّ يُغْنِيَا عَنْهُمَا
 وَضَرَبَ اللَّهُ مَثَلًا مِّنَ اللَّهِ شَيْئًا وَقِيلَ ادْخُلَا النَّارَ مَعَ الدَّٰخِلِينَ
 لِّلَّذِينَ آمَنُوا امْرَأةً فِرْعَوْنَ اِذْ قَالَتْ
 رَبِّ ابْنِ لِي عِنْدَكَ بَيْتًا فِي
 الْجَنَّةِ وَنَجِّنِي مِّنْ فِرْعَوْنَ
 وَمَرِيَمَ ابْنَتَ وَصَدَقَتْ بِكَلِمَاتِ رَبِّهَا وَكُتِبَ عَلَيْهَا مِنَ الْقَانِتِينَ
 عِمْرَانَ الَّتِي أَحْصَنَتْ فَرْجَهَا فَنَفَخْنَا فِيهِ مِن رُّوحِنَا

"Atyre që mohuan (pabasimtarët), Allahu ju sjell shëmbull gruan e Nuhut dhe gruan e Lutit. Ato të dyja ishin në kurore të dy robërve të mirë nga roberit Tanë, por ato të dyja i

tradhtuan (ne fe) ato të dy dhe këta të dy nuk mund t'i mbrojnë fare tek Allahu, e atyre dyjave u thuhet: "Hyni të dyjat në zjarrë së bashku me ata që hyjnë". E atyre që besuan, Allahu u solli shembull gruan e Faraonit, kur ajo tha: "Zoti im, më bë një vend pranë meshirës Sate në xhennet dhe me shpëto prej Faraonit e brutalitetit të tij dhe më shpëto prej popullit mizor! Edhe Merjemen bijen e Imranit, që e ruajti nderin e vet, e Ne prej anës Sonë i frymezuam një shpirt e ajo i besoi fjalët e Zotit të saj dhe librat e Tij dhe ishte e devotshme."

Dhe shumë prej grave, të cilat shkonin të Pejgamberi [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] dhe ankoheshin për padrejtësitë që u bëheshin nga të afërmit e tyre, apo nga dikush tjetër, e ai [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] i ndihmonte dhe largonte padrejtësinë prej tyre. Siç është rasti me atë të cilën e ndaloi vëllau i saj të martohet me atë që ajo dëshironte, dhe ajo shkoi dhe iu ankua Pejgamberit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], pastaj zbriti ajeti: "Nëse pelqejnë mes vete ashtu si kerkojnë rregullat, mos i pengoni që te martohen per burrat e tyre". **فَلَا تَعْضُوهُنَّ أَنْ يَنْكِحْنَ أَزْوَاجَهُنَّ**

Poashtu edhe rasti i asaj, të cilën deshti ta martoi babai i saj, për atë që ajo nuk dëshironte, e pastaj ajo iu ankua Resulull-llahut [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] e ai ia dha të drejtën që të zgjedhe ajo vet, e ajo tha: "Une pranoj atë që ka dashur babai im, por deshta t'ua bëj me dije grave të tjera,se nuk ka prindi në këtë çështje të drejtë."

Paraqet Islami barazinë ndërmjet të drejtave dhe obligimeve ndaj gruas në rrethin familjar, ku thotë All-llahu xh.sh:

**وَلَهُنَّ مِثْلُ الَّذِي عَلَيْهِنَّ وَلِلرِّجَالِ عَلَيْهِنَّ دَرَجَةٌ وَاللَّهُ عَزِيزٌ حَكِيمٌ
بِالْمَعْرُوفِ**

"Edhe atyre (grave) u takon e drejta sikurse edhe përgjegjësia në bashkëshortësi."

Pejgamberi [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] ka paralajmëruar se ummeti i tij do t'i pasojë të humburit dhe ata ndaj të cilëve është zemruar Allahu.

Transmetohet nga Saidi [radijallahu anhu] se Pejgamberi [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] ka thënë: "Do t'i pasoni traditat e popujve para jush pëllëmbë pas pëllëmbë dhe hap pas hapi edhe nëse ata hyjnë në birën e hardhucës do t'i ndiqni. ... Këtë ummet e ka kapluar injoranca dhe risitë (bidatet) nga popujt e mëparshëm si Jehudët, Krishterët, Persianët, Romakët, Ilirët etj. I pasuan ata në besimet e tyre, drejtimet, moralin dhe metodat e tyre. Duhet pastruar shhoqëria bashkëkohore nga disa veti jo të mira jo progresive sidomos sa i përket temës në fjalë të drejtat e femrës.

Prandaj, obligohen muslimanët që të kenë kujdesë në këtë e të mos mashtrohen me ata njerëz, të cilët i përkasin Islamit por e injorojnë realitetin e tij dhe binë në këto vepra nga injoranca dhe padituria. Apo ndoshta nuk e injorojnë realitetin e Islamit por i veprojnë këto gjëra qëllimisht. Pra, në këtë rast mëkati është i madh.

Të vështrosh gjendjen e familjes në përgjithësi e në veçanti të nënës në shoqërin joislame dëgjon dhe lexon gjëra të çuditshme. Në ditët e sotme mund të gjeshë në tregje apo rrugë duke ecur nënën me të birin, a po me të bijën e saj apo babain me birin apo bijën e tij. E disa herë nuk të gjeshë familje të kompletuar, e cila del nëpër tregje apo në ç'farëdo

pastron dhe renditë shtëpinë, përgatitë ushqimin, etj.

Pyeti ajo: E kush shpenzon dhe e mbanë atë, pasiqë ajo nuk punon?Tha mjeku: Unë.

Pyeti sërish: E gjërat e saja personale, kush ia blen?: Unë i blej krejt çka dëshiron ajo.

Pyeti: Ti i blen gruas tënde çdo gjë?Tha: Po.

Pyeti me habi ajo: Ia blen edhe arin, dhe gjërat me të shtrenjta?Tha : Po.

Tha ajo: Vërtetë gruaja yte qenka mbretëreshë.

Pastaj u betua mjeku, se ajo mandej kishte dashur të shkurorëzohet nga burri i saj, por me kusht që te martohet me një musliman dhe të largohet nga puna e mjekes e të qëndrojë në shtëpi siç qëndron gruaja muslimane.

Islami rolin dhe rëndësinë e femrës e shikon hsumë nga këndi nënë andaj edhe e ngritë tre shkallë më lartë se sa mahskulli. Thotë El-Hafidh bin Haxher se Ibën Bettali ka thënë: Është e natyrshme që të jenë për nënën tre shëmbuj që nuk janë për babain. Kjo për shkak të vështërisë së nënës gjatë shtatzënisë, lindjes së fëmiut dhe gjidhënjes. Në këto tri gjëra veçohet nëna dhe ndien vështirësi e pastaj babai e shoqëron atë në edukim.

Argument për këtë është fjala e All-llahut [subhanehu ve teala] ku thotë:

وَوَصَّيْنَا الْإِنْسَانَ بِوَالِدَيْهِ حَمَلَتْهُ أُمُّهُ وَهَنَا عَلَى وَهْنٍ
وَفِصَالَهُ فِي عَامَيْنِ أَنْ اشْكُرْ لِي وَلِوَالِدَيْكَ إِلَيَّ الْمَصِيرُ

“Ne njeriun e kemi urdhëruar për (sjellje të mira ndaj) prindërit të vet, sepse nëna e vet atë e barti me mund pas mudi dhe pas dy viteve ia ndau gjinin. (e porositëm) Të jeshë mirënjohës ndaj Meje dhe ndaj dy prindërve tu, pse vetëm te Unë është kthimi juaj.”

Zoti, prindërit i barazoi në edukim. Mirëpo, nënën e ka veçuar me tri gjëra. Thotë Kurtubiu: Qëllimi është që nëna e meriton prej fëmijës së saj rrespektin më të madh dhe ka përparësi në rrepekt ndaj babait.

Thotë Ajjadi: Shumica e dihtarëve janë të mendimit se nëna e meriton mbikqyrjen më të madhe se sa babai. Është thënë se mirësia ndaj atyre dyve është e njejtë por mendimi i parë është më i saktë.

Islami ka urdhëruar për rrespektimin dhe vizitën e nënës edhe nëse është e krishtere.

Transmetohet nga Esmat bja e Ebu Bekrit [radjallahu anha] se ka thënë: Në kohën e Pejgamberit [salallahu alejhi ve sel-lem], nëna ime më mori e ajo ishte e krishtere. E pyeta Pejgamberin [salallahu alejhi ve sel-lem] për këtë duke i thënë: O i Dërguari i Allahut, nëna ime më ka marrë dhe ajo nuk është në pajtim me mua, a e vizitohet atë? Tha Pejgamberi [salallahu alejhi ve sel-lem]: “Po, vizitohet nënën tënde!”

Muhamdedi a.s tek varri I nënës së tij qau dhe bëri dua.

Nga ana tjetër, nënat meritojnë shumë më tepër respekt sesa festimi i një dite të vitit për to. Islami i urdhëron fëmijët që të kujdesen e t'i respektojnë ato në çdo kohë të vitit dhe t'u binden atyre për çdo gjë, përveçse nëse kërkojnë diçka që është në kundërshtim me urdhërat e Allahut.

tregimi kur qe pyetur Abdull-llah Bin Umeri: “Nena ime eshte e moshuar, nuk mund te levize fare, dhe me duhet ta bart ne çdo vend, madje edhe kur ta kryen nevojën.

Nganjehere nuk ka fuqi qe ta permbanë veten keshtuqë, kryen nevojën duke qene ne duart apo shpinen time...A mendon se une e kam kryer obligimin ndaj saj? Ibni Omeri u pergjegj: A e ke harruar femijerine tende kur edhe ju vepronit keshtu me nene tuaj?! Ju po i sherbeni duke shpresuar vdekjen e saj, ndersa ajo iu sherbente juve, me gjithë

mundimet dhe lodhjet qe kishte, dhe prape shpresonte jeten dhe lumturine tuaj”. Vertet dallim i madh ne mes ketyre dy qendrimeve... Ibn Uthejmin Nëna e don më shumë fëmijun e sajë se sa fëmiju nënen.Nga mëshira e Allahut.

Hadithi i përseritur disa her,Qoft i turpruar ai që e mrrin nënen apo njërin prindë të vjetër dhe shërbimi ndaj tyre të jetë ajo që e dërgon në xhenet.Pastaj kojshija i Musaut në xhenet.Pastaj tre njerëzit e shpellës .

Një djalosh quhej Alkame.Kur u sëmur shumë gruaja e tij dërgon dikë tekPjegamberi a.s. dhe i thotë se ai është ne ethet e vdekjes.Muhamedi a.s dërgon Aliun,Bilalin, Selmanin dhe Ammarin dhe kur ata futen tek ai i thonë.”Thuaj. La ilahe ilallah.por goja e tij nuk lëvizi e kuptuan se ai ishte në momentet e fundit të jetës së tij dhe derguan Bilalin prap te Muhamedi a.s. për ti rrefyer rreth gjendjes së tij.Muhamedi a.s pyeti Ai i ka prindërit gjallë.I thanë se babai i ka ndrruar jetë ndërsa nëna e tij është shumë e moshuar.

Muhamedi a.s e dërgoi Bilalin tek nëna e Alkames dhe I tha thuaj asaj, nëse mundësh të vijshë të i dërguari i Allahut dhe nëse nuk ka mudënsi unë do të shkoj tek ajo.Kur kuptoi nëna e Alkames këtë gjë tha unë e kamë për detyrë të shkojë tek i zgjedhdri i Allahut.Mori shkopin dhe shkoi.Muhamedi a,s I tha.më thuaj të vërtetën sepse në të kundërten mua më zbret shpallja.çfar mendon ti për Alkamen.Ajo i thotë që falej shumë dhe agjëronte. Shumë dhe ndante sadaka.Muhamedi a.s prap e pyet.Si është sjellë Alkame me ty?Ao i thotë se jamë e zemruar me të.sepse I bindej gruas më shumë se sa mua.i dërguari i Allahut thotë Zemrimi iinënes ia ka lidhur gjuhën atij që të thotë shehadetin.Pastaj i thot Bilalit që të mbledhë një tubë drunjë që ta djegin.Ajo thotë O i dërguar i Allahut fëmijën tim dhe frytin e zemrës sime do të djegësh në zjarrë para duarve të mija?S mundë ta durojë një nënë një skenë të tillë?Muhamedi a.s thotë:O nëna e Alkames dënimi i Allahut është edhe më i fortë dhe nëse do që Allahu ta falë birin tëndë falja dhe bënja hallall sepse pasha Allahun në dorën e të cilit është shpirti im nuk i bën dobi namazi ,as agjërimi ,as sadakaja nëse ti do të jeshë e zemrurar ndaj tij.Atëherë nëna ngrehë duat dhe thotë:Allahë është dëshmitarë dhe ti o i dërguari Allahut se unë tani jamë e knaqrur me tim birë.I kam falë ia kam bërë hallall.Muhamedi a.s i tha Shkoni e shikoni se a është sgjedhur gjuha Alkames se ndoshta nëna e Alkames ka thënë vetëm me gojë atë që nuk e ka në zemër.

Kur bilali arriti tek dera dëgjoi Alkamen duke thënë shehadetinAi ndrroi jetë po atë ditë pas pak çstesh dhe Muhamedi a.s ia fali namazin pasiqë e kishin larë dhe qefinosur pastaj tha tek varri i tij.Muhaxhir dhe ensarë Ai qi që i jep përparsi gruas ndaj nënes nuk i pranohen as farzet as nafilet.. Melhemet 225 citon Hejthemi ne librin e tij “Mexhmea

U potencua se Allahu i lartësuar ka urdhëruar njeriun që ta adhuroj atë mos t’i bëjë shok dhe t’i rrespektoj prindërit siç është shprehur poeti në nje mënyrë tjetër.

Kot i lutesh Zotit kur nënë e babë si ngon
Kot nderon prindërit nëse Zotin nuk adhuron
Pa besin në Një Zot dhe rrespekt prindërve
Xhenetin kotë e ëndërron